

Gjykata e Qarkut në Prishtinë
P No. 445/2010
Data: 22 korrik 2011

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Qarkut në Prishtinë, me Trupin gjykues të përbërë nga:

- 1) Gjyqtari i EULEX-it, Ferdinando Buatier de Mongeot, Kryetar i Trupit Gjykues
- 2) Gjyqtari i EULEX-it, Gianfranco Gallo, Anëtar i Trupit Gjykues
- 3) Gjyqtarja Vendore, Mediha Jusufi, Anëtare e Trupit Gjykues

Të ndihmuar nga procesmbajtësja e nënshkruar, në çështjen penale kundër:

I

Emri: **Slobodan**
Mbiemri: **MARTINOVIĆ**
Nofka: **“Shuki”**
Emri i babës: **Krsta Martinovic**
Data e lindjes: **15.02.1956**
Vendi i lindjes: **Fshati Bostane Novobërdë/Komuna e Novobërdës**
Gjinia: **Mashkull**
Adresa: **Fshati Pllavicë, Novobërdë/ Komuna e Novobërdës**
Gjendja civile: **I martuar, baba i dy fëmijëve**
Niveli edukues: **Shkolla fillore**
Gjendja
financiare: **Mesatare**
Profesioni: **Ngarës**
Kombësia: **Serb**
Nënshtetësia: **Kosovar**

II

Emri: **Srecko**
Mbiemri: **MARTINOVIĆ**
Nofka: **“Traja”**
Emri i babës: **Krsta Martinovic**
Data e lindjes: **17.02.1952**
Vendi i lindjes: **Fshati Bostane (Novobërdë)**
Gjinia: **Mashkull**
Adresa: **Fshati Bostane, Novobërdë/ Komuna e Novobërdës**
Gjendja civile: **I martuar, baba i tre fëmijëve**
Niveli edukues: **Shkollën e mesme**
Gjendja
financiare: **E varfër**

Profesioni: **Zyrtar i Policisë**
Kombësia: **Serb**
Nënshtetësia: **Kosovar**

1. *Krime lufte kundër popullatës civile, në kundërshtim me nenin 142, të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KPRSFJ-së), aktualisht e dënueshme nën nenet 23 dhe 120 (2) të KPK-së, në kundërshtim me nenin e përbashkët 3 të katër konventave të Gjenevës, të 12 gushtit 1949 ("neni i përbashkët 3") dhe nenet 1 dhe 17, të Protokollit II, të 08 qershorit 1977, shtesë tek Konventa e Gjenevës 1949 ("Protokoll Shtesë II"), të gjitha rregullat e së drejtës ndërkombëtare efektive në kohën e konfliktit të brendshëm të armatosur, në Kosovë dhe në të gjitha kohët relevante tek akuzat aktuale të pandehurit në cilësinë e tyre si zyrtarë policor serb apo anëtarë të paramilitarëve, në bashkëveprim me njëri tjetrin dhe me anëtarë të tjerë ushtarak dhe paramilitarë, duke përfshirë, Sinisha Filiçin, Ivan Periçin, Dragan Trajkoviçin, Sreten Trajkoviçin, Srgjan Trajkoviçin dhe Novica Pavloviçin, kanë trajtuar në mënyrë çnjerëzore [redacted] dhe [redacted] dy civilë, duke mos qenë pjesëmarrës në armiqësitë, duke i mbajtur ata të mbyllur nën kushte jo njerëzore (në ndyrësi, pa ushqim, ujë dhe përkujdesje mjekësore) rreth Novobërdës, në mes të 19 dhe 22 prillit 1999.*

2. *Krime lufte kundër popullatës civile, në kundërshtim me nenet 22 dhe 142, të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KPRSFJ-së), aktualisht e dënueshme nën nenet 23 dhe 120 (2) të KPK-së, në kundërshtim me nenin e përbashkët 3 dhe nenet 1 dhe 17 të Protokollit Shtesë II, të gjitha rregullat e së drejtës ndërkombëtare efektive në kohën e konfliktit të brendshëm të armatosur, në Kosovë dhe në të gjitha kohët relevante tek akuzat aktuale të pandehurit në cilësinë e tyre si zyrtarë ushtarak dhe paramilitarë serb, duke përfshirë, Dragan Trajkoviçin, Sreten Trajkoviçin, Srgjan Trajkoviçin dhe Novica Pavloviçin, kanë shkelur integritetin trupor dhe shëndetësor të [redacted] dhe të [redacted] dy civilë, duke mos qenë pjesëmarrës në armiqësitë, duke i rrabur ata vazhdimisht, rreth Novobërdës, në mes të 19 dhe 22 prillit 1999.*

III.

Emri: **Svetlana**
Mbiemri: **STOJANOVIĆ**
Nofka: **"Cica"**
Emri i babës: **Tomislav**
Data e lindjes: **09.10.1963**
Vendi i lindjes: **I panjohur**
Gjinia: **Femër**
Adresa: **Fshati Bostanë, Komuna e Novobërdës**
Gjendja civile: **E vetme**
Niveli edukues: **Shkollën e mesme**
Gjendja
financiare: **E varfër**
Profesioni: **Tregtare**
Kombësia: **Sërbe**
Nënshtetësia: **Kosovare**

Për veprën penale sikurse më poshtë, e ndjekur *ex officio*:

3. Krime luftime kundër popullatës civile, në kundërshtim me nenet 22 dhe 142, të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KPRSFJ-së), aktualisht e dënueshme nën nenet 23 dhe 120 (2) të KPK-së, në kundërshtim me nenin e përbashkët 3 dhe nenet 1 dhe 17, të Protokollit Shtesë II, të gjitha rregullat e së drejtës ndërkombëtare efektive në kohën e konfliktit të brendshëm të armatosur, në Kosovë dhe në të gjitha kohët relevante në kohën aktuale, të pandehurit në cilësinë e tyre si zyrtarë të policisë serbe apo anëtarë paramilitarë, në bashkëveprim me zyrtarët e tjerë ushtarak dhe paramilitarë serb, kanë shkelur integritetin trupor dhe shëndetësor të [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] dy civilë, duke mos qenë pjesëmarrës në armiqësitë, duke i rrahur ata, dhe në veçanti duke i goditur [REDAKTUAR] në kokë, me trung druri, në Novobërdë, më apo rreth 21 prillit 1999. H.D.

Pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor më 07 dhe 16 qershor, 12, 13, 14, 19 dhe 20 korrik 2011, në mungesë të të akuzuarve, me praninë e avokatëve mbrojtës, Zhivojin Jokanoviç dhe Dejan Vasiç, dhe me praninë e Prokurorit publik special, pas seancës për këshillim dhe votim/ që Trupi gjykues e bëri më 21 korrik 2011, në pajtim me nenin 392, të KPPK-së, shpalli publikisht dhe me praninë e palëve, sikurse më poshtë:

AKTGJYKIM

Duke e parë nenin 390, paragrafin 3, të KPPK-së, Slobodan Martinoviç, Sreçko Martinoviç dhe Svetlana Stjanoviç,

LIROHEN

Nga të gjitha akuzat e ngritura kundër tyre, sikurse është përshkruar më lart në pikat 1, 2 dhe 3, sepse nuk është dëshmuar se ata kanë kryer krimet për të cilat ishin akuzuar.

Në pajtim me nenin 103, të KPPK-së, shpenzimet e procedurës penale do të mbulohen nga burimet buxhetore të Gjykatës.

Masat e sigurisë, në pajtim me nenin 271, të KPPK-së, me anën e kësaj përfundojnë dhe dokumentet e udhëtimit, të konfiskuara nga ata do të u kthehen.

Kryetari i Trupit Gjykues

Ferdinando Buatier de Mongeot

Anëtari i Trupit Gjykues

Gianfranco Gallo

Anëtari i Trupit Gjykues

Mediha Jusufi

Procesmbajtëse

Jacqueline Ryan

Këshilla ligjore

Në pajtim me nenin 400 (1), të KPPK-së, ankesa mund të bëhet brenda 8 ditësh nga shpallja e këtij Aktgjykimi, dhe, në pajtim me nenin 398 (1), të KPPK-së, ankesa duhet që të dorëzohet në këtë Gjykatë, brenda 15 ditësh nga data kur kopja e Aktgjykimit do të dorëzohet tek palët.